

**MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE
PLATFORMA E MENAXHIMIT**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Në mes

SHOQATANDËRKOMBËTARE E KOMPANIVE TË UJËSJELLËSVE NË ZONËN UJËMBLEDHËSE TË LUMIT DANUB (IAWD)

dhe

INSTITUCIONET MENAXHUESE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE DHE MENAXHIMIN E PLATFORMËS TË PERFORMANCËS SË KOMPANIVE TË UJËSJELLËSVE (IM-T)

Duke konsideruar, që Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive të Ujësjiellësve në Zonën Ujëmbledhëse të Lumit Danub (këtu e tutje referuar si “IAWD”) ka interes që të lehtësojë, mes gjitha shteteve të zonës ujëmbledhëse të lumit Danub, duke ndarë dhe përdorë informacionin për performancën e kompanive të ujit me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sektorit;

Duke konsideruar, që Institucionet Menaxhuese për Mbledhjen e të Dhënave dhe Menaxhimin e Platformës të Performancës së Kompanive të Ujësjiellësve (këtu e tutje referuar si “MI”) dhe individualisht si “MI”) kanë interes që të vlerësojnë dhe përmirësojnë performancën e kompanive të ujësjiellësit dhe kanalizimit në shtetet e tyre përkatëse (këtu e tutje referuar si “Shtetet Pjesëmarrëse”) dhe kundër standardeve rajonale;

Duke konsideruar, që IAWD dhe MI (këtu e tutje referuar si “Palët”, dhe individualisht, secila “Palë”) dëshirojnë që të formalizojnë një bazë mbi të cilën Pala do të bashkëpunojë në zhvillimin e përbashkët dhe menaxhimin e Platformës për mbledhjen e të dhënave për performancën e kompanive të ujësjiellësit dhe kanalizimit (këtu e tutje referuar si “Platforma DCM”) e ndarë nga, por plotësuese për Platformën e ujërave DANUBIS.org;

Sipas përpjekjeve të palëve dhe operimeve të ndërmarra të përbashkëta deri tash me mbështetje financiare dhe teknike të Bankës Botërore/Programi i Ujërave të Danubit IAWD, dhe ne veçanti zhvillimi fillestar i Platformës DCM; si dhe mbështetja teknike e stafit të Bankës Botërore; dhe Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarking (këtu e tutje referuar si “IB-Net”);

Tash, për këtë arsye, Palët kanë rënë dakord që të hyjnë në këtë Memorandum Mirëkuptimi (këtu e tutje referuar si “MM”) si më poshtë:

NENI 1.

OBJEKTIVAT

1. **MM.** Qëllimi i këtij Memorandumi është të formalizojë kornizën qeverisëse sipas së cilës IAWD dhe Mit do të veprojnë së bashku Platformën DCM.
2. **Platforma.** Qëllimi i Platformës DCM është që të lejojë Mit të mbledhin, bëjnë të vlefshme, të ndajnë dhe të raportojnë të dhënat e performancës dhe treguesit e kompanive të ujësjellësit dhe kanalizimit në shtetet e tyre përkatëse, në mënyrë që të vlerësojnë dhe përmirësojnë performancën e shërbimeve në Shtetet Pjesëmarrëse.

NENI 2.

QEVERISJA RAJONALE

1. **Komiteti Drejtues.** Të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me zhvillimet, operimet, mirëmbajtjen dhe financimin e Platformës DCM në nivelin rajonal do të merren nga Komiteti Drejtues i përbërë me nga një përfaqësues të IAWD, dhe një përfaqësues nga secila MI. Një pjesëmarrës nga Banka Botërore do të marrë pjesë vetëm si vëzhgues pa fuqi vendimi. Pjesëmarrësit do të caktohen nga institucionet e veta përkatëse.
2. **Sekretariati.** IAWD, përmes sekretariatit të vet teknik, do të marrë përsipër Sekretariatit e Komitetit Drejtues, duke përfshirë përgatitjen dhe lehtësimin e takimeve të Komitetit Drejtues dhe hartimin dhe shpërndarjen e procesverbalit të vendimeve të marra.
3. **Takimet e Komitetit Drejtues.** Komiteti Drejtues do të takohet së paku një herë në vit ose më shpesh, me propozimin e Sekretariatit të tij ose cilin do MI. Para çdo takimi, Sekretariati do të qarkullojë një komunikatë elektronik për të gjithë Mit duke deklaruar vendimet që do të merren dhe duke ofruar çdo informacion sfondi të nevojshëm. Mit do të ofrojnë mundësinë për të marrë pjesë në takime nga distanca.
4. **Vendimet.** Vendimet do të merren me konsensus kur të jetë e mundur, dhe me shumicë të votave të përfaqësuesve të Mit dhe IAWD të pranishëm ose të pranishëm virtualisht në rast të mosmarrëveshjes. Në rast të një barazimi, vota e përfaqësuesit të IAWD do të përcaktojë vendimin.
5. **Vendimet mes takimeve.** Nëse vendimet formale janë të nevojshme në mes të takimeve, Sekretariati do të ketë mundësi të organizojë një proces vendimi virtual; vendime të tilla do të merren në një mungesë të bazës së kundërshtimit brenda kohës së arsyeshme. Nëse ndonjë përfaqësues i MI ose IAWD kundërshton, do të thirret një takimi i plotë i Komitetit Drejtues.
6. **Vendimet Operative.** Vendimet operative që kanë të bëjnë me implementimin e Komitetit Drejtues do të merren nga Sekretariati. Sidoqoftë, Sekretariati do të operojë nën mbikëqyrjen e Komitetit Drejtues edhe për ato vendime operative dhe secili anëtar i Komitetit Drejtues do të ketë të drejtë që të kërkojë një përditësim apo shpjegim në lidhje me vendimet operative.

NENI 3.

QEVERISJA KOMBËTARE

1. **Një MI për shtetin.** Secili shtet do të ketë vetëm nga një MI. Përveç nëse Komiteti Drejtues pajtohet ndryshe në kushte të jashtëzakonshme. Nëse rrethanat bëjnë thirrje për një ndryshim të MI në shtetin përkatës, do të zbatohen dispozitat e Nenit 3.
2. **Qeverisja kombëtare.** Secila MI do të përcaktojë, në koordinim me aktorët tjerë relevant në shtetin e vet, ndarjen e nevojshme të informacionit, koordinimin dhe/ose marrëveshjet e vendim-marrjes dhe mekanizmat që kanë të bëjnë me implementimin, operimin, mirëmbajtjen dhe financimin e Platformës DCM të shtetit. Këto marrëveshje dhe mekanizma gjithashtu do të mbulojnë sigurimin e qasjes në bazën e të dhënave për të siguruar që të dhënat dhe informacionet janë në dispozicion për të informuar një gamë të gjerë të vendimeve dhe aktiviteteve të aktorëve.

NENI 4.

PRONËSIA

1. **Platforma fillestare DCM.** Pronësia formale e Platformës DCM e zhvilluar nën financim të DWP është me IAWD, e cila ka bërë zhvillimin e saj në emër të Komitetit Drejtues. A duhet që IAWD të vendos që të tërhiqet nga roli i vet dhe përgjegjësitë sipas nenit 4, IAWD do të ketë për detyrë të heq dorë dhe të transferojë pronësinë e plotë dhe të drejtën e përdorimit të Platformës për cilën do organizatë alternative është përcaktuar në kuptim të nenit 1.
2. **Zhvillimet e më tejshme.** Përveç nëse është rënë dakord ndryshe nga Komiteti Drejtues, zhvillimet e mëtejshme të Platformës do të jenë po ashtu formale në pronësi të IAWD ose çdo organizatë pasuese siç përcaktohet në kuptimit e nenit 8.01, pa marrë parasysh burimin e tyre të financimit dhe kontraktimit.
3. **E drejta e përdorimit.** Brenda kontekstit të këtij Memorandumi dhe në raport me ndonjë MI aktual ose të ardhshëm nga rajoni i Danubit, IAWD nuk do të përdorë Platformën DCM për ndonjë qëllim përfitimi, as nuk do të kërkojë ndonjë licencë për përdorim të tij. IAWD do të operojë Platformën DCM rreptësisht nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e Komitetit Drejtues. Përdorimi i mundur ose licencimi i partnerëve jashtë rajonit të Danubit do të diskutohet mbi një bazë rast pas rasti brenda Komitetit Drejtues.
4. **Të dhënat Kombëtare.** Pronësia formale e të dhënave të depozituara në Platformën DCM mbesin me MI përkatëse që ka kontribuar për mbledhjen e tyre. MI-t përkatëse mbesin të lira për t'u përdorur, ndarë, analizuar, ose shpalosur të dhënat me të cilat ka kontribuar në çdo mënyrë që e konsideron të dobishme, pa pasur të bëjë me opinionin e anëtarëve tjerë të Komitetit Drejtues. Pavarësisht kësaj, çdo MI do të përpiqet të sigurojë që të dhënat dhe informacioni i mbledhur të jetë sa më gjerësisht në dispozicion dhe sa më i përdorshëm që të bëhet një depo kombëtare e informacionit duke informuar për aktivitetet e sektorit, më mirëse një bazë të dhënash private.

5. **Të dhënat e centralizuara.** Të dhënat e mbledhura përmes Platformës DCM do të ruhen në një bazë të dhënash qendrore në një server që menaxhohet nga IAWD ose pala e tretë e kontraktuar nga IAWD. Të dhënat nuk do të qasen, të përdoren dhe as të ndahen nga IAWD, qoftë publikisht ose privatisht, në asnjë mënyrë jo shprehimisht të parashikuara nga ky MM, ose miratuar nga Komiteti Drejtues. Nëse IAWD përcakton se nuk mund të përmbushë detyrimin e vet në kuptim të Nenit 6, do të ketë obligim që të transferojë dhe dorëzojë të gjitha të dhënat e centralizuara të cilësdo organizatë alternative që është përcaktuar në kuptim të Nenit 1.
6. **Mbajtja e Platformës DCM.** Marrëveshjet për mbajtjen e Platformës DCM do të bëhen duke marrë parasysh kompromiset mes besueshmërisë së hyrjes dhe të dhënave të sigurisë, si dhe shpenzimet operative. IAWD do të bëjë një propozim të Komitetit Drejtues, i cili do të miratojë marrëveshjet fillestare dhe çdo ndryshim të rëndësishëm. IAWD nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëm, qoftë në aspektin e humbjes së qasjes, humbjes apo vjedhjes së të dhënave, pësuar nga MI si rezultat i dështimit të ofruesit të mbajtjes dhe marrëveshjeve të pranuar nga Komiteti Drejtues.
7. **Të dhënat e dërguara në IB-Net / DANUBIS.** Të dhënat e transmetuara në IB-Net/ DANUBIS në bazë vjetore në kuptim të Nenit 7. NENI 6.1.11 g) nuk do të konsiderohen si pronësi ekskluzive e MI por më parë do të bëhen pjesë e bazës së të dhënave të përgjithshme të përbashkëta të IB-Net, dhe menaxhohen sipas maturisë së IB-Net. Indikatorët relativ do jenë në dispozicion për të gjithë në rajon dhe më gjerë përmes IB-Net dhe platformës DANUBIS, dhe IB-Net do të ketë të drejtë të pakufizuar për të shpërndarë të dhënat themelore për përdorim të hulumtimit.

NENI 5.

FAZAT E IMPLEMENTIMIT

1. **Faza e nisjes.** Faza e nisjes së Platformës DCM do të filloj me hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi dhe do të përfundoj kur i pari MI ka vënë me sukses Platformën në punë të rregullt në shtetin e vet.
2. **Faza e mbështetjes së DWP.** Platforma e DCM e fazës mbështetëse të DWP do të fillojë në fund të Fazës së Nisjes dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2018, data e tanishme mbylljes së DWP.
3. **Faza e DWP pas.** Platforma DCM pas fazës DWP do të fillojë në fund të fazës mbështetëse DWP dhe vazhdon deri sa të ndërpritet MM në përputhje me kërkesat e Nenit 11.

NENI 6.

OBLIGIMET E IAWD

1. **Obligimet e përgjithshme.** IAWD do të veprojë gjithë kohën në mënyrë që të promovojë suksesin e MM dhe të Platformës DCM. IAWD në veçanti do të:
 - 1.1. Ofrojë funksionin e Sekretariat për Komitetin Drejtues.
 - 1.2. Merr pjesë në takimet e Komitetit Drejtues dhe në mënyrë aktive kontribuon në diskutime.
 - 1.3. Zbaton vendimet e Komitetit Drejtues që kanë të bëjnë obligimet e tyre.
 - 1.4. Mbanë web-faqen e Platformës DCM si dhe bazën e të dhënave themelore, në lidhje me marrëveshjet e rëna dakord në kuptim të Nenit 4.06.
 - 1.5. Lehtëson në mënyrë aktive diskutimet me Shtetet Pjesëmarrëse potenciale.
 - 1.6. Me përkushtim e njofton Komitetin Drejtues në rast se është në një situatë për të vazhduar sigurimin e obligimeve të veta sipas këtij memorandumi; dhe në rast të tillë të lehtësoj diskutimet mes MI-ve që kanë të bëjnë me rregullimet alternative.
2. **Faza e Nisjes.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë fazës së nisjes, IAWD do të:
 - 2.1. Zhvilloj Platformën DCM dhe siguroj reagimet dhe kërkesat e MI-ve dhe Komitetit Drejtues të merren parasysh deri në atë masë të mundshme të arsyeshme;
 - 2.2. Siguroj përgatitjen e materialeve të trajnimit, duke mbuluar nevojat e përdoruesve të ndryshëm të platformës së DCM.
 - 2.3. Organizoj trajnime për përfaqësuesit e MI-ve.
 - 2.4. Përgatisë një propozim fillestar për mbajtjen e Platformës DCM në kuptim të Nenit 4.pika 6, për aprovim nga Komiteti Drejtues.
3. **Faza mbështetëse e DWP.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë fazës mbështetëse të DWP, IAWD do të:
 - 3.1. Siguroj që Platforma e DCM të mirëmbahet dhe që gabimet e mundshme të adresohen.
 - 3.2. Ofroj mbështetje teknike të kufizuar për MI-t.
4. **Faza DWP më pas.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë fazës më pas të DWP, IAWD do të: Lehtësoj diskutimet në lidhje me financimin dhe rregullimet e organizimet për Platformën DCM.
5. **Delegimi i obligimeve.** Në çdo moment në kohë, IAWD mund të vendos që të delegojë pjesë të obligimeve për palën e tretë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin, mirëmbajtjen dhe Platformën DCM. Sido çoftë çdo delegim, ose ndryshim i marrëveshjes së delegimit, do të kërkonte një aprovim nga Komiteti Drejtues
6. **Shpenzimet.** Gjatë fazës së nisjes dhe mbështetëse të DWP, IAWD do të bartë të gjitha shpenzimet në përputhje me obligimet e veta sipas MM. Sidoqoftë, gjatë fazës më pas-DWP, IAWD do të kenë të drejtë që të ri-mburohen në mënyrë të drejtë nga ana MI-ve, për

shpenzimet që kanë të bëjnë me përmbushjen e obligimeve në vazhdim sipas këtij Memorandumi. Në këtë drejtim IAWD do të përgatisë, në kohën e duhur, një propozim për shqyrtim dhe miratim të Komitetit Drejtues se si këto shpenzime duhet të ndahen në mënyrë të drejtë. Nëse nuk gjendet ndonjë marrëveshje, do të zbatohen dispozitat e nenit 8.01.

NENI 7.

OBLIGIMET E MI

1. **Obligimet e përgjithshme.** MI do të veprojnë gjithë kohën në mënyrë që të promovojnë suksesin e MM dhe suksesin e Platformës SCM DANUBIS në perspektivën e shtetit dhe në nivelin rajonal. MI në veçanti do të:

1.1 Menaxhojnë Platformën dhe mbledhjen e të dhënave relative dhe procesin e miratimit në shtetet e tyre përkatëse, duke emëruar burime të mjaftueshme të stafit administrativ dhe menaxherial.

1.1 Në mënyrë aktive të promovojnë përdorimin Platformës së DCM për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave të performancës së shërbimeve të shteteve dhe më gjerë.

1.2 Udhëheq në nivel kombëtar shkëmbimin e informacionit, koordinimin dhe mekanizmat e vendimmarrjes dhe përgatitjes që kanë të bëjnë me Platformën DCM, të përmendura në Nenin NENI 3.2.

1.3 Merr të gjithë hapat e mundshëm për të siguruar që të dhënat e mbledhura në kuadër të Platformës DCM janë përdorur për të informuar politikatat dhe përmirësojnë performancën e shërbimeve Brenda dhe përtej MI, duke përfshirë, sipas nevojës, duke iu dhënë qasje në të dhënat e nevojshme dhe treguesve institucioneve tjera në nivel kombëtar ose lokal.

1.4 Merr pjesë në takimet e Komitetit Drejtues dhe në mënyrë aktive kontribuon në diskutime.

1.5 Implementon vendimet e Komitetit Drejtues që kanë të bëjnë me obligimet e tyre.

1.6 Pranon pjesëmarrjen e tyre në Platformën e DCM dhe inkurajon homologët nga shtetet tjera që të marrin pjesë gjithashtu.

1.7 Çdo vit të paraqesë në ekipin e IB-Net, përmes Bankës Botërore, grupin e plotë të të dhënave të IB-Net për të gjitha shërbimet në Platformën e DCM, për publikim në IB-Net dhe portalet DANUBIS.org.

1.8 Nxjerrë rregullisht të dhënat e ruajtura në platformën e DCM për të siguruar se ato janë ruajtur dhe janë në qasje në rast të një dështimi të platformës.

1.9 Siguroj

2 **Faza e Nisjes.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë Fazës së Nisjes, MI do të:

2.1 Siguroj përkthimin dhe çdo material mbështetës të nevojshëm (veçanërisht doracakët e trajnimit) në gjuhën përkatëse kombëtare ose gjuhët sipas nevojës.

2.2 Përgatisë dhe vendos të dhëna historike nga vitet e mëparshme, sipas nevojës (të dhëna që tashmë janë në dispozicion ose të parashikuara në formatin IB-Net do të përfshihen automatikisht).

- 2.3 Ofroj çdo informacion të nevojshëm për IAWD të rregullojë Platformën, në veçanti logot, tekstet, informacion për login dhe listën variable dhe indikatorëve.
 - 2.4 Merr pjesë në trajnime rajonale të MIit organizuar nga IAWD.
 - 2.5 Kryej organizimin e nevojshëm, vlerësimin dhe pilotimin e Platformës në rrethanat e shtetit.
 - 2.6 Trajnoj shërbimet dhe stafin e tyre në përdorimin e Platformës.
- 3 **MIiti bashkohen pas Fazës e Nisjes.** Në rast se MIi bashkohen Platformës DCM pas kompletimit të fazës së nisjes, obligimet fillestare të tij do të jenë të njëjta siç është përshkruar në Nenin 2, derisa nisja e Platformës në shtetin e tyre të jetë e suksesshme, pas së cilës obligimi do të kalohet në ato të përshkruara në fazën e përgjithshme në të cilën është Platforma DCM.
 - 4 **Faza mbështetëse DWP.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë Fazës mbështetëse të DWP, MIi do të:
 - 4.1 Operojnë dhe menaxhojnë Platformën DCM në atë mënyrë që të sigurojnë institucionalizim dhe qëndrueshmëri të mëtutjeshme të Platformës në shtetet e tyre përkatëse.
 - 4.2 Ofrojnë trajnime të vazhdueshme të personelit të shërbimeve përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin në shërbimet e tyre përkatëse.
 - 4.3 Raportojnë çdo çështje dhe sugjerim për përmirësim në IAWD.
 - 5 **Faza e DWP më pas.** Përveç obligimeve të përgjithshme, gjatë fazës së DWP pas. IMt do të ketë të njëjtat obligime si në fazën mbështetëse të DWP. Përveç IMt do të:

Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të Komitetit Drejtues që të sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të Platformës DCM në afat gjatë.
 - 6 **Delegimi obligimeve.** Në çdo moment në kohë, MIi mund të vendosin të delegojnë një pjesë të obligimeve te pala e tretë.
 - 7 **Shpenzimet.** Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me IAWD, çdo MI do të bartë të gjitha shpenzimet që lidhen me përputhshmërinë me obligimet e veta sipas këtij Memorandumi. Përveç kësaj, çdo MI do të marrë pjesën e vet të drejtë të kostove të Platformës së DCM, siç është përcaktuar me Nenin 6.06.

NENI 8.

PËRPUETHSHMËRIA

1. IAWD. IAWD është angazhuar për të përmbushur obligimet sipas këtij memorandumi. Nëse IAWD megjithatë e gjen veten në një situatë që nuk mund të jetë në përputhje me obligimet e veta, do të sjellë vëmendjen e Komitetit Drejtues në mundësinë e parë që Komiteti Drejtues mund të vendos në mekanizmin më të mirë për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të Platformës. Mekanizmat e rinj duhet kapur në një amendament të këtij Memorandumi sipas nenit 2, dhe duhet respektuar parimet e këtij memorandumi.

2. MIIt. Çdo MI është angazhuar për të përmbushur obligimet sipas këtij memorandum. Sidoqoftë, nëse MI vet, apo ndonjë anëtarë i Komitetit Drejtues, konsideron se ndonjëri nga MI nuk është në gjendje për të përmbushur ndonjë detyrim te vetin, Komiteti Drejtues do të shqyrtojë provat dhe, nëse konfirmohet, të kërkojë nga MI për të adresuar mos-pajtueshmërinë në kohën e duhur, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, me një ndryshim të MI në kuptim të nenit 3. Në rast të përsëritjes apo vazhdueshmërisë së mos- përputhshmërisë së çdo MI, Komiteti Drejtues mund të vendos të përjashtojë MI që nuk është në përputhje me platformën DCM. Në këtë rast do të zbatohen parimet e përshkruara në 2.

NENI 9.

PJESËMARRJA DHE TËRHEQJA

1. **Pjesëmarrja e MIIt.** Pjesëmarrja e MIIt në Platformë do t'i nënshtrohet procesit të mposhtëm:
 - 1.1 IAWD dhe stafi i Bankës Botërore do të kenë diskutimet e para me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të vendit për të konstatuar pjesëmarrjen e propozuar në Platformën DCM në përputhje me parimet bazë të përcaktuara në këtë Memorandum.
 - 1.2 Pas marrëveshjes, MIi ardhshëm do të dërgojë një Letër të Qëllimit në Komitetin Drejtues për të konfirmuar se ai ka për qëllim që të veprojë si MI për shtetin përkatës, t'i bashkohet Platformës DCM, nënshkruaj dhe t'iu përmbahet parimeve të këtij memorandum.
 - 1.3 IAWD do të paraqes pjesëmarrjen e propozuar të MI në Komitetin Drejtues, i cili do të aprovojë atë (në një mungesë të kundërshtimit përveç nëse një MI kërkon një takim të plotë). Pjesëmarrja e një MI të ri në parim nuk do të refuzohet përveç nëse ka arsye serioze teknike.
 - 1.4 MI do të nënshkruajë këtë Memorandum.
 - 1.5 Pas nënshkrimit të Memorandumit, MI do të përgatisë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për përshtatur funksionimin e platformës për rrethanat e veta specifike;
 - 1.6 Nëse nënshkrimi i Memorandumit dhe transmetimi i përshtatjes së dokumentacionit do të bëhet gjatë nisjes së fazës mbështetëse të DWP, IAWD do të organizoj përshtatjen e platformës bazuar në kontributet e MI. Nëse kjo ndodhë gjatë fazës më pas të DWP, MI do të duhet që të mbulojë shpenzimet e përshtatjes nga resurset e veta.
2. **Tërheqja e MI-ve.** MIIt janë të lira për tu tërhequr nga Platforma e DCM në çdo kohë pas njoftimit nga IAWD dhe pa kushte ose justifikime. Pas largimit nga platforma, MIIt do të:
 - 2.1 Kenë të drejtë të kërkojnë një kopje të plotë të të dhënave të ruajtura në bazën e të dhënave të centralizuar, në një format të eksportueshëm nga Platforma DCM;
 - 2.2 Kenë të drejtë të kërkojnë, nëse konsiderohet e nevojshme, që të gjitha të dhënat historike që kanë të bëjnë me shtetin përkatës të fshihen nga baza e të dhënave të platformës së DCM. Kjo megjithatë nuk mbulon të dhënat e transferuara në vit për IB-Net/DANUBIS në kuptim të Nenit 7.11.7, që do të mbetet në të bazën e të dhënave të IB-Net për të gjithë përdoruesit për qasje në IB-Net / DANUBIS.

- 3 **Ndryshimi i MI.** Nëse rrethanat e arsyetojnë atë, një ndryshim i MI për shtetin pjesëmarrës mund edhe të ndodhë., për shembull nëse korniza ligjore e ndërron rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve në vend. Në rast të tillë, duke e lënë dhe duke hyrë në MI do të dërgojë një komunikatë të përbashkët në të cilën të dy MI do të informojnë Komitetin Drejtues për qëllimin e tyre në dorëzimin dhe përgjegjësinë e MI; dispozitat e Nenit 1 do të ndiqen për të formalizuar dorëzimin. Pas përfundimit të dorëzimit, IAWD do të transferojë të gjitha të drejtat e qasjes nga largimi deri në hyrje të MI, duke përfshirë qasjen në dhe të drejtat për përdorim të bazës së të dhënave. Nëse duhet ta lënë MI dhe dëshirojnë që të marrin një kopje të bazës së të dhënave, kjo do të përmendet gjithashtu në shënimin e dorëzimit.
- 4 **Tërheqja e IAWD.** Nëse duhet IAWD të vendos, për çfarëdo arsye, se dëshiron të tërhiqet nga roli i vet dhe obligimet sipas këtij Memorandumi, do të zbatohen dispozitat e nenit NENI 4.1 pika 1 dhe nenit 1.

NENI 10.

KANALI I KOMUNIKIMIT DHE NJOFTIMI

- 4.1 **Nënshkruesit.** Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të këtij Memorandumi nga Palët, kanali i komunikimit të Palëve do të jetë përmes personit që nënshkruan këtë MM në emër të MI ose IAWD.
- 4.2 **Delegimi.** Në momentin e nënshkrimit të MM ose në çdo moment pas kësaj, personi që e nënshkruan këtë MM mund të delegojë, me një njoftim me shkrim të Komitetit Drejtues, një person tjetër për të përfaqësuar MI në të gjitha format e komunikimit sipas këtij Memorandumi.
- 4.3 **Forma e Komunikimit.** Përveç nëse është rënë dakord ndryshe nga Komiteti Drejtues, të gjitha komunikimet për dhe nga Komiteti Drejtues do të kalojnë nëpër IAWD e cila do të sigurojë shpërndarjen e tij (Komunikimi hyrës) dhe miratimin paraprak (Komunikimi i jashtëm) nga të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues.
- 4.4 **Gjuha e komunikimit.** Gjuha zyrtare për të gjitha komunikimet me gojë dhe me shkrim sipas këtij Memorandumi është gjuha angleze.

NENI 11.

AMENDMENTI, NDËRPRERJA DHE ÇËSHTJE TJERA

1. **Hyrja në fuqi.** Ky Memorandum hynë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga IAWD dhe të paktën një MI.
2. **Amendamenti.** Ky Memorandum mund të ndryshohet vetëm me vendim të Komitetit Drejtues.
3. **Publikimi.** Secila Palë, pa marrëveshje paraprake nga palët e tjera, e bëjnë këtë Memorandum publik në ueb faqe të DANUBIS.org ose përmes ndonjë kanali tjetër që e konsideron të përshtatshëm.

4. Ndërprerja. Ky Memorandum mund të ndërpritet vetëm me vendim të Komitetit Drejtues ose nga tërheqja e të gjithë MI-ve nga Platforma DCM.

5. Çështje tjera. Këto dhe aktivitete tjera për të rënë dakord ndërmjet palëve do t'i nënshtrohen objektivave të brendshme përkatëse, funksioneve, politikave dhe procedurave të Palëve.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët nënshkruese, secila duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të vet me detyrë të autorizuar, ka nënshkruar këtë Memorandum të Mirëkuptimit në dy (2) homologë origjinal në gjuhën angleze në datat e treguara më poshtë.

Për IAWD



Data: _____

Nënshkrimi:

Delegimi në kuptim të Nenit 4.2:

Walter Kling
Sekretar i Përgjithshëm

Philip Weller
Kryesues i Sekretariatit Teknik
Praterstrasse 31/20
1020 Vienna, Austria
Tel ++ 43 1 217 0748
Email weller@iawd.at

Për ARRU

Llogo

Data: 08.09.2016

Nënshkrimi:

Delegimi në kuptim të Nenit 4.2:

Vet, ose sipas nevojës

Raif Peteni
Drejtor

NË DËSHMI TË KËSAJ, si një shenjë e mbështetjes por jo një shenjë e obligimeve as e zotimit.

Për Bankën Botërore



Data: _____

Nënshkrimi:

Delegimi në kuptim të Nenit 4.2:

Vet, ose sipas nevojës

Patricia Lopez
DWP Leader/WB